



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 34, datë 27.02.2025

PËR

**“PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË
VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË PËRSHPEJTUAR ME KËRKESË PËR
PROKUROREN BLERTA HAMZA”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar (në mungesë)
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/Kryetar
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar (në mungesë)
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.02.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 e vijues, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

***“Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së Vlerësimit Etik dhe Profesional të
Përshpejtuar me kërkesë për prokuroren Blerta Hamza”***

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim, relacionin shoqërues nr. 360 prot., datë 25.02.2025, të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, referuar bazës ligjore të lartpërmendur, si edhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli), me vendimin nr. 285, datë 17.07.2023, Këshilli shpalli 2 (dy) vende vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Me shkresën nr. 1991 prot., datë 31.07.2023, të aplikimit në procedurën sipërcituar, zonja Blerta Hamza, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ka bashkëlidhur dhe kërkesën e saj për vlerësim të përshpejtuar.
2. Këshilli duke qenë se, deri në atë moment prokurorja Blerta Hamza, nuk kishte asnjë vlerësimin të realizuar në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve"* i ndryshuar, me vendimin nr. 312, datë 29.09.2023, për *"Miratimin e programit që përcakton listën e prokurorëve, që do të vlerësohen me procedurë të përshpejtuar"* i ndryshuar, ka filluar procesin e vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional për 2 (dy) magjistrate, ku pjesë e këtij procesi është edhe prokurorja Blerta Hamza.
3. Me vendimin nr. 313, datë 29.09.2023, të Këshillit *"Për caktimin me short të relatorit dhe këshilltarit ligjor përgjegjës për procedurën e vlerësimit të përshpejtuar me kërkesë për prokuroret Blerta Hamza dhe Vitjuna Mata"*, për vlerësimin me procedurë të përshpejtuar për prokuroren Blerta Hamza u përzgjedh relator zoti Zeqir Hoda dhe Këshilltar Ligjor përgjegjës për vlerësimin zoti Olgert Rumnici.
4. Në bazë të ligjit nr. 96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, dhe nenit 17 të Rregullores *"Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve"* e ndryshuar, prokurores Blerta Hamza i është komunikuar fillimi i procedurës së vlerësimit dhe emrat e Relatorit dhe Këshilltarit Ligjor përgjegjës për vlerësimin, si dhe e drejta për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe/ose Këshilltarit përgjegjës për vlerësimin. Me email prokurorja ka njoftuar se nuk ka konflikt interesi me Relatorin dhe Këshilltarin Ligjor përgjegjës.
5. Këshilltari Ligjor përgjegjës për vlerësimin ka verifikuar çështjet të cilat janë përfunduar tej afateve ligjore, sipas përcaktimeve të nenit 24, pika "b", si dhe anekseve "1" e "2" të Rregullores *"Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve"* i ndryshuar. Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në zbatim të nenit 91 të ligjit nr. 96/2016, *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, neneve 23 deri 31 dhe anekseve 1 e 2 të Rregullores *"Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve"* e ndryshuar, u miratua Urdhri dhe vendimi i Relatorit për zhvillimin e procedurës së shortit dhe përzgjedhjen e dosjeve.

6. Pasi u administruan dosjet e përzgjedhura me short nga relatori, Këshilltari Ligjor përgjegjës për vlerësimin vijoi punën me përgatitjen e raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të përshpejtuar me kërkesë për prokuroren Blerta Hamza.

7. Këshilli gjithashtu vëren se, pavarësisht procedurës së mësipërme, më parë me vendimin nr. 140, datë 06.06.2022 *“Për miratimin e programit që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional individual përgjatë vitit 2022”*, si dhe nr.141, datë 06.06.2022 *“Për miratimin e planifikimit tremujor të vlerësimit etik dhe profesional individual të prokurorëve, përgjatë vitit 2022”*, kishte filluar procesin e vlerësimit periodik etik dhe profesional, për vitet 2017-2019, për zonjën Blerta Hamza, procedurë e cila përfundoi me vendimin nr. 250, datë 26.11.2024, ku u miratua edhe Vlerësimi Etik dhe Profesional Periodik për këtë prokurorë.

8. Ndodhur në këto kushte, Këshilli shqyrtoi situatën e re të krijuar dhe çmon se me përfundimin e vlerësimit periodik, etik dhe profesional, realizohet kërkesa ligjore që për kandidim, qoftë për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, prokurorja të ketë një vlerësim të tillë. Për këtë arsye rezulton se tashmë mungon arsyeja dhe qëllimi se, përse u pranua nga Këshilli kërkesa për realizimin e një vlerësimi etik dhe profesional të përshpejtuar.

9. Me qëllim arritjen e një vendimmarrje sa më të drejtë, Këshilli, iu referua edhe ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”* i ndryshuar, nga ku rezulton se në nenin 97, pika 2, ndër të tjera parashikohet se; ... *“Magjistrati vlerësohet me procedurë të përshpejtuar, sipas kërkesës së tij, në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet sipas parashikimeve të këtij ligji për aq sa është e mundur”*. Pra, duke qenë se vlerësimi periodik, u përfundua, së fundmi, ky parashikim ligjor, ndalon Këshillin që të vijojë më tej, me procedurën e vlerësimit të përshpejtuar.

10. Ndodhur përballë këtyre vendimmarrjeve të ndryshme të Këshillit, konstatohet se ligji nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, i ndryshuar, si edhe ligji nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar, nuk kanë asnjë parashikim për të rregulluar këtë situatë në mënyrë konkrete, por akti i fundit ligjor, në nenin 189, pika 3 të tij, parashikon se *“Këshilli i Lartë i Prokurorisë zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast apo situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”*.

11. Për këtë arsye, Këshilli duke iu referuar Kodit të Procedurave Administrative, vëren se ky ligj në nenin 95 të tij parashikon se: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*.

12. Në rastin konkret, Këshilli konstaton se qëllimi pse u kërkua procedura e vlerësimit të përshpejtuar ishte fakti që magjistratja nuk kishte vlerësime të mëparshme. Në kushtet kur, për këtë magjistrate, u miratua një vlerësim etik dhe profesional dhe konkretisht ai periodik, atëherë qëllimi i procedurës së vlerësimit të përshpejtuar është bërë i pamundur, bazuar edhe në

parashikimin e nenit 97, pika 2 të ligjit nr. 96/2016 i ndryshuar, të cituar më sipër, që kërkon që ky vlerësim të bëhet nëse magjistratja nuk ka pasur një të tillë, dy vitet e fundit.

13. Gjithashtu, mos realizimi i procedurës së vlerësimit të përshpejtuar, nuk e penalizon magjistraten për shkak se, me miratimin e vlerësimit të parë të saj periodik, ajo nuk ka asnjë pengesë për të kandiduar si për lëvizje paralele ashtu edhe për ngritje në detyrë.

14. Këshilli, në zbatimin e kësaj dispozite verën se, edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, në praktikën e tij, në një rast të ngjashëm, me vendimin nr. 349, datë 9.9.2021, ndër të tjera ka arsyetuar se: *“Zhvillimi i kësaj procedure, e cila inicohet pas kërkesës së gjyqtarit për lëvizje paralele ose ngritje në detyrë dhe kualifikimit të tij për plotësim të kriterëve ligjore, synon të garantojë zhvillimin e një procesi të shpejtë, efektiv dhe të njëjtë vlerësimi për periudhën përkatëse të vlerësimit, për të siguruar të paktën 1 vlerësim profesional në kohë, të njëjtë dhe real me atë të kërkesës së gjyqtarit për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele. Në kushtet kur procedura e ngritjes në detyrë, për shkak të së cilës ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin kalendarik 2019 ka përfunduar dhe njëkohësisht gjyqtarja {...} nuk është përfshirë në programin e vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2021, rezulton se, shkak për të cilin procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar ka filluar, nuk ekziston më dhe për pasojë, zhvillimi i kësaj procedure të posaçme vlerësimi, ka humbur qëllimin për të cilin ka filluar”.*

15. Pra, ndodhur në këto kushte, procedura e vlerësimit të përshpejtuar nisur nga Këshilli, me vendimin e tij nr. 312, datë 29.09.2023, e ka humbur qëllimin e tij përsa i përket prokurores Blerta Hamza dhe kjo procedurë duhet të mbyllet pa një vendim përfundimtar.

16. Një tjetër argument, në favor të kësaj vendimmarrjeje është edhe parashikimi i nenit 17 të Kodit të Procedurave Administrative, dispozitë e cila parashikon që: *“1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë. 2. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë”.*

17. Në rastin konkret duke qenë se, asnjë prokuror në Shqipëri, nuk ka dy vlerësime, të realizuara në bazë të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”* i ndryshuar, atëherë me qëllim që të gjithë prokurorët të trajtohen në mënyrë të barabartë nga Këshilli, duhet që ato të të paisen të gjithë më nga një vlerësim, dhe më pas të kalohet në vlerësimet e dyta për secilin prokuror. Vetëm në këtë mënyrë, realizohet barazia e plotë e tyre, në të gjitha procedurat e konkurimit, duke mbetur të gjithë në kushte objektive të njëjta. Miratimi i një vlerësimi të dytë, për këtë prokuror do të përbënte një avantazh të padrejtë, i cili do të cenonte parimin e barazisë, për më tepër kur nuk ndodhemi përballë karakteristikave objektive që mund ta bëjnë këtë rast të veçantë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës, nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, nenet 159, pika 1 dhe 2 germa “a”, 184 dhe 189, pika 1 të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar, nenin 97 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe*

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenit 35 të Rregullores “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve” e ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të përfundojë pa vendim përfundimtar procedurën e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Përsheptuar me kërkesë për prokuroren Blerta Hamza.
2. Të njoftohet për këtë vendimin prokurorja Blerta Hamza.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmbja e njoftimit të vendimit të arsyetuar vetëm për shkelje të rënda procedurale.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 27.02.2025.

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla